



Ultrazëri gjatë shtatëzaniës - çfarë duhet të dini

Ultrazëri është metoda e vetme me të cilën mund të vëzhgohet drejtpërdrejt fëmija i palindur në mitër (të nënës). Në Zvicër ultrazëri përdoret gjatë shtatëzaniës që 40 vjet. Deri më sot nuk është konstatuar asnjëherë ndonjë ndikim i drejtpërdrejtë për fëmijën apo nënën. Tek kontrollimet e zakonshme në javën e 11-të dhe të 20-ën të shtatëzaniës si dhe për ultrazërin si indikacion (tregues) shpenzimet do të barten nga sigurimi shëndetësor.

Një kontrollë e ultrazërit duhet të jap përgjigje në pyetjet me sa vijon:

Në një të tretën e parë (të kohës) së shtatëzaniës (java e 11-14 e shtatëzaniës):

- Zbulimi se fëmija është gjallë dhe gjendet në vendin e duhur në mitër
- Konstatimi i kohës së shtatëzaniës. Kjo është e një rëndësie të madhe, për shembull që të mund të bëhet konstatimi në shtatëzaniën e vonëshme të një zvogëlimi të rritës së fëmijës.
- Shquarjen (dallimin) e binjakëve apo më shumë.
- Përfundimin e të metave të rënda të fëmijës
- Matja e transparencës së qafës si tregues (shenjë) për një çrregullim të mundshëm të kromosomeve (p.sh. sindromi Down)

Në një të tretën e dytë të shtatëzaniës (java e 20-23 e shtatëzaniës):

- Vlerësimi i sasisë së ujit të barrës dhe rritjes së fëmijës
- Shquarja (dallimi) e të metave të rënda
- Përcaktimi i pozitës së anit

Nëse konstatimet e ultrazërit janë normale, mund të niseni nga ajo se gjasat më të mëdha janë se me të vërtetë çdo gjë është në rregull. Mirëpo, a mund t'ju garantojë, nëse kontrolli i ultrazërit është (tregon) normal, se fëmija juaj do të jetë i shëndoshë? **Jo**, kjo nuk është e mundur.

Ultrazëri bën shumë mirë (me 90% saktësi) për zbulimin e problemeve të rënda të fëmijës (probleme, të cilat nuk lejojnë mbijetesën e fëmijës). Ultrazëri është mjaft i mirë (me 75% saktësi) për dallimin (shquarjen) e problemeve të cilat kërkojnë një përkujdesje dhe terapi intenzive. Mirëpo ultrazëri nuk është në gjendje (me 30% saktësi) të shoh për njohjen e të metave të parëndësishme (si **p.sh.** gishtërinj të tepërt), meqë këso hollësira nuk mund të paraqiten tek të gjithë. Përveç kësaj ne mund të konstatojmë nganjëherë ndryshime të vogla, ta zëmë të tilla si forma e kokës, të cilat nuk kanë një koficient (vlerë) të sëmurjes, por që megjithatë tregojnë një bazë të sëmurjes së veçantë. Nëse mundet që pasojat e kësaj sëmurje të veçantë të përjashtohen, atëherë treguesi i shenjave nuk ka më ndonjë rëndësi.

Merreni parasysh gjithashtu se disa çrregullime të zhvillimit shfaqen tek gjatë shtatëzaniës, prandaj në gjysmën e parë të shtatëzaniës akoma nuk dallohen. Një konstatim (diagnozë) i ultrazërit ndikon në trajtimin e shtatëzaniës më tutje dhe me këtë ta qetësojë dukshëm. Nëse zbulohet ndonjë problem, ultrazëri na jep bazën e rëndësishme për të vendosur. P.sh. ju mund të parapërgatiteni për lindjen e një fëmije të sëmurë. Lindja mund të planifikohet për një hapësirë kohore. Ngandonjëherë edhe një terapi gjatë shtatëzaniës mund të përmirësojë gjendjen shëndetësore.



Mirëpo ultrazëri me rastin e zbulimit të ndonjë çregullimi të rëndë të fëmijës mund të sjellë edhe tek një konflikt etik të vendimit: "A duhet ta vazhdoj shtatëzaninë apo të bëjë një ndërprerje urgjente?" Shumëkush heqin dorë, në përgjithësi u largohen konfliktit dhe pranojnë vullnetin e natyrës. Prandaj, ju lutemi të na njoftoni nëse për këso arsyerash nuk doni ultrazërin. Nëse keni paqartësira ose ndonjë pyetje ne ju japim me dëshirë njoftime plotësuese.

- Unë jam dakord për zbatimin e kontrollit me ultrazë të fëmijës tim
- Unë jam dakord me zbatimin e kontrollit me ultrazë të fëmijës tim me përkufizimet vijuese.
- Unë dua të heq dorë nga kontrolli me ultrazë. Unë kam kundërshtimet / pyetjet me sa vijon.